



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1260, datë 28.04.2010

Për

“Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.04.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 2) e Nenit 68 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni per **Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)”** eshte pergatitur ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator perkates.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- realizimin e dhenies ne perdorim ne nje kohe sa me te pershtatshme te brezave **UMTS**;
- krijimin e kushteve per nje treg mobil perspektiv konkurent;
- perdorimin ne menyre eficienteb te brezit te frekuencave UMTS te disponueshem;
- realizimin e zgjidhjeve që sjellin përfitime më të mëdha për abonentët ne vecanti dhe per ekonomine shqiptare ne pergjithesi;
- realizimin e zgjidhjeve që janë neutrale nga pikëpamja e teknologjisë;
- realizimin e zgjidhjeve që janë plotësisht në përputhje me legjislacionin aktual të BE,

bazuar ne piken 1 dhe 2) te Nenit 68, pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë **Dokumentin per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtave te perdorimit ne brezat e frekuencave 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz qe ofrojne sherbime me brez te gjere (UMTS)”** sipas dokumentit bashkëlidhur
2. Keshillimi publik fillon ne daten e publikimit ne mediat e shkruara kombetare dhe nderkombetare dhe zgjat 30 dite.
3. Njoftimi për këtë keshillim të botohet në gazeta të rëndësishme me qarkullim ndërkombëtar dhe në gazeta të përditshme në vend.

4. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit www.akep.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alketa MUKAVELATI

2. Benon PALOKA

3. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURCE

NJOFTIM PER KESHILLIM PUBLIK
MBI
DHENIEN NE PERDORIM TE BREZAVE TE FREKUENCAVE
1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, dhe 2110-2170 MHz
PER SHERBIMET UMTS (*Universal Mobile Telecommunications System*)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), mbështetur në nenin 68 të ligjit nr.9918, dt.19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nis keshillimin publik për dhenien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave **”UMTS-Universal Mobile Telecommunications System” 1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz**

AKEP, në mënyrë që :

- të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave ;
- të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave për çdo brez) ;
- të njohë çmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar ; si dhe
- të mundësojë krijimin e një terreni të pershtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

zhvillon këtë keshillim publik përpara se të futet në procesin përfundimtar të dhënies në përdorim të këtyre brezave.

Materiali i mëposhtëm përmban opinionet e AKEP, shpjegime si dhe pyetjet për pjesëmarrësit në këtë keshillim publik.

A-Te përgjithshme :

Në tregun botëror, rrjetet dixhitale të telefonisë së lëvizshme kanë njohur një “boom” zhvillimi në dy dhjetëvjeçarët e fundit.

Si në vendet e tjera të Europës konkurrenca vitet e fundit është futur edhe në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, që aktualisht ka të autorizuar katër operatore: AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile, dhe Al-04

Gjenerata e tretë (3G) e sistemeve të komunikimit të lëvizshëm në sajë të suksesit të rrjetëve të gjeneratës së dytë (2G) si GSM, do të jetë e aftë t’ju sigurojë përdoruesve aplikime në kufij të gjere nepermjet kapacitetit të lartë të shërbimeve multimediale. Këto mundësi të reja do të vijne nepermjet tre inovacioneve kryesore :

- aksesit në brez të gjere radiofrekunce (broadband radio-frequency);
- arkitekture e rrjetit inteligjent (intelligent network architecture), duke lejuar akses të vetëm me një numër më të madh shërbimesh;
- konvergjenca midis rrjetëve të fiksit dhe të lëvizshmit, të cilat aktualisht janë në zhvillim.

Synimi i Qeverisë është:

Implementimi i një procesi dhëniesh të drejtash përdorimi objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatorëve shqiptarë dhe ekonomisë shqiptare, i cili përfshin futjen e shërbimeve 3G, krijimin e një tregu “të lëvizshëm” konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit.

Pjesemarresit ne kete keshillim jane te ftuar te bejne komentet e tyre mbi secilen nga ceshtjet, qe jane trajtuar ne kete dokument.

Pergjigjet e marra do te behen publike dhe do te jene pjese e nje informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin.

Pjesa e pare:

1.Cfare ofron UMTS

1.1.Tipi i sherbimeve.

Kushti kryesor qe AKEP mendon te vendosë është maksimalizimi i shërbimeve publike të komunikimit (te lëvizshme dhe fikse), rritja e cilesise se tyre si dhe ofrimi i cmimeve te favorshme.

Ky kusht lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, si dhe përmirësimin e ambientit konkurrues në tregun e shërbimit publik të komunikimeve elektronike.

Pyetje:

-Cilat sherbime dhe aplikime do te garantojne suksesin e rrjeteve UMTS?

-A do te behen sherbimet UMTS sherbime konsumi masiv ne treg? Neqoftese po, per cfare periudhe kohe?

-Cfare kushtesh do te jene optimale per akses ne keto sherbime referuar territorit-gjeografise?

1.2.Futja e sherbimeve UMTS eshte nje faktor themelor ne konvergjencen e telekomunikimit/kompjuterit/radio-televizionit dhe fiks/mobile.

Pyetje:

- Cfare roli do te luajne UMTS ne konvergjencen e telekomunikimit/kompjuterit/radio-televizionit dhe fiks/mobile.

1.3. Si ne nivel aksesit ashtu edhe ne rrjet UMTS eshte nje pjese integrale ne rritje e arkitektures se rrjeteve satelitore dhe tokesore. Versioni i fundit i IPV6 siguron specifikimet mbi formatin dhe mekanizmin e perdorur per menaxhimin e mobilitetit dhe sigurise.

Pyetje:

-Cfare pasojash do te kete futja e internet protokollit ne rrjetet e UMTS, ne interkoneksion, adresa, emertime, akses te kushtezuar etj?

-AKEP fton sipermarresit te japin mendime mbi zhvillimet ne arkitekturen e rrjetit qe do te jete e nevojshme per te mbeshtetur nderveprimin eficient te UMTS me internetin ose ndryshe ne pergjithesi me rrjetet e bazuara ne teknologjine IP.

-A do te kete pasoja kjo ne ekonomi, konkurrence dhe ne termat rregullatore?

1.4. Akses ne sherbimet online

Pyetje:

AKEP fton pjesemarresit te bejne komente mbi kerkesat per akses ne sherbimet “online” dhe mbi pozicionin e GSM ne lidhje me UMTS ne kete fushe.

Pjesa e dyte

2. Kushtet dhe termat ne lidhje me autorizimet UMTS

Kjo pjese e keshillimit ka lidhje me pergatitjen e fazes perfundimtare per dhenien e autorizimeve UMTS.

2.1. Grafiku i leshimit te autorizimit

Plani kombetar i radiofrekuencave (PKRF), vendimet dhe rekomandimet e CEPT/ECC, ligji per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise, etj., jane dokumentet kryesore qe do te mbahen parasysh ne trajtimin e kesaj ceshtje.

AKEP shpreson qe dhenia e autorizimeve per operatoret UMTS do te rrise interesin e sipermarresve edhe ne nivel nderkombetar. Ne kete kuptim, AKEP deshiron te siguroje operatoret e ardhshem UMTS se ekziston aftesia dhe mundesia e tregut shqiptar te komunikimeve elektronike per perthithjen e ketyre investimeve. Gjithashtu, AKEP siguron keta operatore te ardhshem se procesi i dhenies te ketyre autorizimeve do te jete transparent dhe konform te gjitha ligjeve qe jane ne fuqi dhe kane lidhje me kete proces. Lidhur me parashikimet, AKEP mendon se Qershor 2010 eshte afati me i afert per shpalljen e gares dhe dhenia e ketyre autorizimeve do te jete Tetori i vitit 2010.

2.2. Burimet e spektrit per operatoret UMTS

Plani Kombetar i Radio Frekuencave percakton brezat ku mund te autorizohen sherbimet UMTS. Ne perputhje me praktiken e ndjekur nga te gjitha vendet e Europes, AKEP propozon qe fillimi i ofrimit te sherbimeve UMTS te behet ne brezat:

1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, dhe 2110-2170 MHz.

Ne kuptim te ketij dokumenti “spekter UMTS” do te kuptojme brezat e mesiperm te radiofrekuencave

2.3. Prioritetet e perdorimit te spektrit UMTS

AKEP mendon qe te drejtat e perdorimit ne brezat UMTS te jepen nepermjet procedures se tenderit duke i konsideruar te barabarte te gjitha pjesmarresit ne gare.

2.4. Kohezgjatja e vlefshmerise se Autorizimeve dhe numri i tyre


AKEP mendon qe vlefshmeria e nje autorizimi te leshuar te jete 10 vjet.

Pyetje:

-A jeni dakort me kete kohezgjatje vlefshmerie autorizimi? Ne se jo, sa mendoni?

AKEP ka arritur ne perfundimin qe operatorit UMTS minimalisht i duhet si fillim te kerkoje 2x15 MHz te ciftuar simetrike ne brezat 1920-1980/2110-2170 (breza te ciftuar) dhe/ose nje bllok 5 MHz ne brezin 1900-1920 dhe 2010-2025 MHz (breza te paciftuar).

Ne perputhje me praktikat e zbatuara ne shumicen e vendeve te Europes, AKEP ka vendosur qe brezat ne diskutim te jepen ne perdorim (shfrytezohen) sipas diagrames se meposhtme:



Autorizimet	Frekuencat	Modulimi
Autorizimi A	2x15 MHz spekter i ciftuar (1920-1935 ciftuar me 2110-2125) dhe 5 MHz spekter i paciftuar (1900-1905)	FDD TDD
Autorizimi B	2x15 MHz spekter i ciftuar (1935-1950 ciftuar me 2125-2140) dhe 5 MHz spekter i paciftuar (1905-1910)	FDD TDD
Autorizimi C	2x15 MHz spekter i ciftuar (1950-1965 ciftuar me 2140-2155) dhe 5 MHz spekter i paciftuar (1910-1915)	FDD TDD
Autorizimi D	2x15 MHz spekter i ciftuar (1965-1980 ciftuar me 2155-2170) dhe 5 MHz spekter i paciftuar (1915-1920)	FDD TDD

AKEP, nisur nga sa me sipër, mendon se numri i pritshëm i të drejtave të përdorimit që do të jepen mund të jetë deri në 4 (kater), (edhe kur do të përdoret brez i ciftuar do të konsiderohet një e drejtë përdorimi).

Kufizimi i numrit të të drejtave për të përdorur frekuencat lidhet me brezin e kufizuar në dispozicion të këtij shërbimi dhe me detyrimin e përdorimit sa më efikas të tyre.

2.5. Cmimi për brezat e dhënë në përdorim

Pyetja:

- Cila është vlera që jeni të gatshëm të paguani për Autorizim sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.4 të këtij dokumenti?

2.6. Zgjedhja e operatoreve UMTS

Për këtë çështje AKEP do të mbështetet në ligjin Nr. 9918 dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” nëni 7, nëni 67, 68, 69 dhe VKM Nr.479 dt.04.05.2009 (Plani Kombëtar i Radio Frekuencave-PKRF) e VKM nr. Nr.1252 datë 10.9.2008 etj.

2.7. Kriteret e kualifikimit

-Kriteret e për zgjedhjes

Aplikimi i procedurës së tenderit publik të përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”.

-Kriteret e vleresimit

AKEP fton sipërmarresit të formulojnë kritere në lidhje me:

- Ndarjen në faza për mbulimin me shërbim:
 - sipas shtrirjes gjeografike, dhe
 - mbulimit të popullsisë,
- Shërbime të disponueshme
 - telefoni
 - internet
 - multimedia etj
- Pagesat e operatorëve për akses në frekuencat e UMTS

3. A ka ndonjë çështje tjetër për tu marrë në konsideratë në këtë proces?

NJOFTIM
për
KËSHILLIM PUBLIK

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), mbështetur në nenin 68 të ligjit nr.9918, dt.19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, njofton të gjitha palët e interesuara se nis keshillimin publik për dhenien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave ”*UMTS-Universal Mobile Telecommunications System*” **1900-1980 MHz, 2010-2025 MHz, 2110-2170 MHz**. Te interesuarit duhet të shprehin mendimet e tyre brenda 30 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

Dokumentacioni përkatës gjendet i publikuar në faqen e web të AKEP:

www.akp.gov.al

Per informacion mund te kontaktoni ne adresen e email:

info@akep.gov.al